



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:038773
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728213

C.nr.128/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, në çështjen juridike kontestuese të paditësit N.I. nga të cilin me autorizim e përfaqëson av.Lulzim Canaj nga Kamenica, kundër të paditurve, N.H., A.H. të dy nga D. S. nga dhe M. S. nga, me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së fitimit të pronësisë, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore më datë 20.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të vdekjes të paditësit N.I. nga dhe të paditurit M. S. nga, të treguar si në padi.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e paditësit dhe të paditurit M.S.e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palëve.

A r s y e t i m

N. I. nga të cilin me autorizim e përfaqëson av.Lulzim Canaj nga Kamenica, ka parashtruar kundër të paditurve, N.H., A. H. të dy nga D. . S. nga dhe M.S. nga me vendbanim në, me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së fitimit të pronësisë.

Përmes parashtrësës të pranuar nga Zyra Gjendjes Civile- Komuna e Kamenicës, gjykata ka konstatuar se paditësi N. I. ka ndërruar jetë me date 09.08.2023, fakt ky I provuar në bazë të certifikatës së vdekjes me nr. rendor 336, të datës 26.04.2024, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile- Komuna e Kamenicës, si dhe i padituri M. S., ka ndërruar jetë me datë 24.10.1976, fakt

ky I provuar në bazë të certifikatës së vdekjes me nr. rendor 6, të datës 26.04.2024, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile- Komuna e Kamenicës

Andaj, duke marrë parasysh të lartë cekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, komfor nenit 277 pika a të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PËR ÇËSHTJE CIVILE**

2020:038773, 20.05.2024

Gjyqtarja,
Valbonë Dërvodeli,d.v.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.